



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 09/11/2021

Proces-verbal

Në kuadër të takimeve që Bashkia Korçë organizon për Paketën Fiskale të vitit 2022, datë 04.11.2021, me përfaqësuesin e Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Korçë, si dhe Albert Nasto kryetar i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë.

Viti 2021 ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me përfaqësuesit e biznesit dhe shoqatat, duke bërë herë pas here konsultime mbi problematikat e kësaj shtate që shkaktoi Covid-19, me prioritet lehtësimin e barrës fiskale për biznesin.

Në këtë takim u diskutua për Paketën Fiskale të vitit 2022, evidentimin e sfidave për të ardhmen si dhe mundësinë për lehtësimin e bizneseve.

Gjatë takimit u evidentua bilanci pozitiv i Bashkisë Korçës përsa i përket raportit regjistrim-çregjistrim. Një tjetër meritë e Bashkisë Korçë e cila doli në pah gjatë këtij takimi ishte ecuria me hapa konkretë të formalizimit të biznesit, duke synuar vendosjen në pozita të barabarta të të gjitha bizneseve. Përsa i përket ndryshimeve në Paketën Fiskale për vitin 2022, nga ana e bashkisë po mendohet të mos ketë rritje të barrës fiskale për familjarët dhe për biznesin. Për shkak të situatës ekonomike të rënduar, familjet në vështirësi ekonomike do të përjashtohen nga taksat dhe tarifat e pastrimit, gjobërimit dhe ndriçimit për vitin 2022.

Në fokusin e bashkisë do të vijojnë të jenë bizneset e reja. Bizneset në fushën e artizanatit, Teknologjisë së Informacionit dhe biznese që hapen nga të huaj nuk do të kenë asnjë tarifë gjatë vitit të parë të ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Kryetari i Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm përgjatë këtij takimi listoi kërkesat e tij si në vijim:

1. Ndarjen me këste të pagesës së taksave dhe tarifave vendore në mënyrë që të mos rëndojnë ekonomikisht mbi biznesin.
2. Kontrolle sa më të pakëta nga ana policisë dhe shmangia e gjobave.

Konceptoi
Lorena Saro

Drejtoreshë e Marrëdhënieve me Publikun dhe
Informimit Qytetar
Larisa Katundi